



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 5 Mars 2022

Nr: 129

V E N D I M

P Ë R

**DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJES SË DY QENDRAVE
TË VOTIMIT NË BASHKINË DURRËS, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE
TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit nr. 13438, datë 20.01.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenit 62, pika 4, nenit 93, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja, sipas përcaktimit të nenit 62, pika 4, të Kodit Zgjedhor.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 47, datë 07.02.2022 “Për caktimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në bashkitë Shkodër, Durrës, Dibër, Vorë, Rrogozhinë, Lushnjë të datës 6 Mars 2022”, miratoi vendndodhjet e disa qendrave të votimit në ndërtesa private, bazuar në propozimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga kryetarët e bashkive.

Për QV nr. 1347 dhe QV nr. 1347/1, miratuar me vendimin sipërcituar, me vendndodhje në lokalin me pronësi të z. Sefer Hoxha, nga administrata e KQZ-së dhe inspektoret, janë raportuar shqetësime nga një subjekt politik në lidhje me vendndodhjen e QV, e cila ishte në ambient të një anëtari të PS. Në KQZ është administruar kërkesa e bashkisë Durrës, me propozimin për ndryshimin e



Data: 5 Mars 2022

Nr. 129

“Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së dy qendrave të votimit në bashkinë Durrës, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022”

vendndodhjes së dy qendrave të votimit nr. 1437 dhe 1437/1, nga lokali i z. Sefer Hoxha, në ambientet si më poshtë:

- QV nr. 1347 të jepet autorizim për zhvendosje në lokalitë e z. Florian Tila;
- QV nr. 1347/1 të jepet autorizim për zhvendosje në lokalitë e z. Hekuran Elezi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenin 62, pika 4, nenin 93 pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 3, të udhëzimit nr. 1, datë 05.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjes së hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”,

V E N D O S I:

1. Dhënie e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së nr. 1437 nga lokali i z. Sefer Hoxha, në lokalitë në pronësi të z. Florian Tila, dhe QV-së nr. 1437/1 nga lokali i z. Sefer Hoxha, në lokalitë në pronësi të z. Hekuran Elezi, Bashkia Durrës.
2. Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore të kryejë menjëherë njoftimin me shkrim të zgjedhësve për vendndodhjen e dy qendrave të votimit, të caktuar me këtë vendim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

